



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 21.09.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.09.2023, të parashtruar nga Operatori ekonomik **Ermal Dina B.I**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “**Renovimi dhe adaptimi i objekteve të çerdhes Ganimete Tërbeshi**”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-7721-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-117 -521, **nxjerr**:

**V E N D I M**

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: **Ermal Dina B.I, e dt.19.09.2023**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Renovimi dhe adaptimi i objekteve të çerdhes Ganimete Tërbeshi**”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-7721-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-117 -521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 14.09.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: **14.09.2023**;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik **Ermal Dina B.I. me dt.19.09.2023**, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Renovimi dhe adaptimi i objekteve të**

çerdhes Ganimete Tërbeshi", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-7721-5-2-1,  
Nr. i brendshëm-632-23-117 -521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 21.09.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është i pabazuar, sepse edhe pas kërkesës për sqarim të tenderit **ju**, nuk keni prezantuar kontrata të natyrës së ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) me çka nuk përmbushur kërkesat e Autoritetit kontraktues në FDT.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

**Faton Gutaj**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;

